



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4165 prot.

Vlorë, më 19.03 2024

PROJEKT -VENDIM

PËR

**“MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
PËRMBYTJA E BANESËS TË Z.DENIS IZETAJ DHE SHPËRBLIMIN
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË”.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja në banesën e z.Denis Izetaj, e ndodhur në lagjen “Hajro Çakërri”, Rajoni Nr.1, Bashkia Vlorë, në datën 08.11.2023, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 135.993 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë për mobilje dhe pajisje elektorshtëpiake.

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

Koncept. *E.Kamberi*

Miratoi: *A.Vreshtazi*

KRYETAR
ERMAL DREDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLERË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 4165 prot.

Vlorë, më 19.03 2024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJA NË BANESËN E Z. DENIS IZETAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLERË”

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.301 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Z.Denis Izetaj në datën 13.11.2023 ka paraqitur kërkesën me Nr14080 prot, për shkak të përmbytjes së banesës e ndodhur në lagjen "Hajro Çakërri", pranë ish fabrikës së çimentos, Rajoni Nr.2, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 15.11.2023, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.14080/1 prot, datë 26.01.2024 Dërgohet dokumentacioni për banesën e përmbytur të z.Denis Izetaj, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.2636, datë 20.02.2024 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së përmbytur të z.Denis Izetaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

Vlera e dëmeve në banesën e z.Denis Izetaj është 135.993 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë për mobilje dhe pajisje elektorshtëpiake.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmbytja në banesat e z.Denis Izetaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

Konceptoi: E.Kamberi



DREJTOR

Adrian Vreshtazi

